

KËRKESË

Nr. 1509/7, datë 16.5.2017

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve të Brendshme, shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Sistemim blloqe banimi Zogu I, Krah i djathtë (Zyra e Punës, Drejtoria e Bujqësisë), Bashkia Shkodër.

Subjekti kërkuar është Bashkia Shkodër. Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vemë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur, në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët do të likuidohen për efekt shpronësimi me paraqitjen e dokumentave të rregullta të pronësisë, pas daljes së vendimit të Këshillit të Ministrave, që do të miratojë kërkesën për shpronësim. Vlera totale e shpronësimit është 411 580 (katërqind e njëmbëdhjetë mijë e pesëqind e tetëdhjetë) lekë.

**ZËVENDESMINISTRI I PUNËVE
TË BRENDSHME
Elona Gjebrea**

Bashkia Shkodër

[illegible]